

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
DREJTORINË QENDRORE TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT
DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Drejtorinë Qendrore të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2012 deri 30.07.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 180, datë 24.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 768/15, datë 24.12.2014, i ka rekomanduar z. Artan Lame, Drejtor i ALUIZNI, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Rregullorja e Brendshme e ALUIZNI-t, është miratuar nga ish Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t me shkresën nr. 62, datë 16.01.2008, *“Rregullore e Brendshme e funksionimit të ALUIZNI-t”* dhe trajtohen objekti, bazën ligjore, detyrat për sektorët në Drejtori të Përgjithshme dhe në qarqe, detyrat e përgjithshme të çdo drejtorie dhe sektori, por nuk ka miratim nga Ministri i Linjës në kundërshtim me ligjin nr. 90/2012 datë 27.09.2012 neni 29 pika 2 *“Rregulloret e brendshme”* ku thuhet: *“Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij”*. Duhet theksuar se kjo rregullore është e vitit 2008, dhe nuk ka asnjë rregullore të re të përditësuar, pavarësisht se kanë ndryshuar strukturat.

1.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore ALUIZNI të merren masa që në zbatim të ligjit nr. 90/2012, datë 27.09.2012, neni 29, pika 2 *“Rregulloret e brendshme”*, të rishikojë dhe përmirësojë Rregulloren e Brendshme të Institucionit, në përputhje me ndryshimet organizative.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se nuk ka shkresë nga ana e NA të njësisë, për delegimin e rolit të koordinatorit të riskut tek një nëpunës tjetër i nivelit menaxherial. Nuk janë përcaktuar përgjegjësitë e personave që do të merren me menaxhimin e riskut, pavarësisht se sipas përcaktimeve në ligj kjo është detyrë e vetë NA, në kundërshtim me ligjin nr. 10269, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

2.1 Rekomandim: Nga Nëpunësi Autorizues të përcaktohen përgjegjësitë e personave që do të merren me menaxhimin e riskut.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të ligjit nr. 10269, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, nga Drejtorët e Përgjithshëm nuk është formuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS).

3.1 Rekomandim: Nga Nëpunësi Autorizues të krijohet GMS, në zbatim të ligjit, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga ana e stafit të lartë, të mesëm dhe të ulët menaxherial, nuk janë kryer trajnime të mjaftueshme për njohjen e tyre me kërkesat e ligjit, njohjen me procesin e evidentimit dhe menaxhimit dhe monitorimit të riskut, në kundërshtim me ligjin nr. 10269, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

4.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa që të kryhen trajnime të stafit, mbi njohjen dhe procesin e implementimit të MFK-së.

Vazhdimisht.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në këtë institucion ka munguar Kodi i Brendshëm Etik, ku të jenë inkuadruar parimet bazë të etikës, së nëpunësit, veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e konfliktit të interesave” me ndryshime, si dhe të ligjit 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

5.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa për hartimin dhe miratimin e Kodit të Brendshëm Etik, ku të pasqyrohen kërkesat e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e konfliktit të interesave” me ndryshime, si dhe të ligjit 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Brenda darës 31.01.2015

6. Gjetje nga auditimi: Nuk është hartuar një listë mbi proceset e punës, ç’ka do të shërbente edhe për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit. Ky veprim është në kundërshtim me kërkesat e manualit për MFK. Në Manualin për MFK, në shtojcën nr. 3 janë demonstruar disa raste të proceseve të punës, për hartimin e listës ose hartës.

6.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa që të hartohet harta e proceseve të punës, si dhe nxjerrjen e një udhëzimi të brendshëm ku të përshkruhen dhe dokumentohen me hollësi; procesi, nën proceset, objektivi i procesit, struktura përgjegjëse, përshkrimi i procesit, njësitë dhe strukturat që përfshihen në proces, kuadri ligjor dhe afati kohor.

Brenda muajit Shkurt 2015

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se nuk janë dokumentuar kërkesat për llogaritjen e nevojave për mallra e shërbime të Autoritetit Kontraktor (AK), nuk janë përcaktuar zyrtarët që do të hartojnë përlllogaritjen fondit limit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit, pika 2, “Llogaritja e vlerës së kontratës”.

7.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa që të dokumentohen kërkesat për llogaritjen e nevojave për mallra e shërbime të AK, të përcaktohen zyrtarët që do të hartojnë përlllogaritjen fondit limit dhe dokumentimin e tij.

Vazhdimisht.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në një rast urdhri i prokurimit ka dalë para lindjes së nevojave, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika “ç”.

8.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa që urdhri i prokurimit të dalë me paraqitjen e kërkesës për punë, mallra e shërbime.

Vazhdimisht

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua përdorimi jo i drejtë i procedurës së prokurimit publik konkretisht; përdorimi i procedurës negocim pa shpallje në vend të procedurave të tjera, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Qëllimi i ligjit” dhe neni 33, “Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu IV, “Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”, pika 5, “Procedura me negocim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës” pika a.

9.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa për përdorimin e saktë të procedurave të prokurimit publik në përputhje me kërkesat e LPP-së.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në të gjitha rastet e paraqitjes së ankimeve të operatorëve ekonomik në AK, shqyrtimi i tyre nuk është deleguar për shqyrtim një zyrtari apo zyre brenda autoritetit, sipas kërkesës së VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu IX, “Shqyrtimi i ankesave”, pika 1, “Ankesat në autoritetin kontraktor”.

10.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa që në rastet e paraqitjes së ankimeve, shqyrtimi i tyre të delegohet një zyrtari apo zyre brenda autoritetit, për të dhënë një rekomandim për titullarin, sipas kërkesës të tyre e ligjeve në fuqi.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në të gjitha rastet e anulimit të procedurave në këtë AK, nuk janë analizuar shkaqet që kanë shkaktuar dështimin e procedurave të prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, pika “b”.

11.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa që të analizohen shkaqet që kanë shkaktuar dështimin e procedurave të prokurimit dhe të zbatohen procedurat e caktuara ligjore.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar, se Certifikatat e pranimi të mallrave, nuk janë hartuar në përputhje me Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

12.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa që Certifikatat e pranimi të mallrave të hartohen në përputhje me Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar se në asnjë rast për periudhën e audituar nuk është mbikëqyrura dhe dokumentuar zbatimi i kontratës së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të ambienteve.

13.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa që të mbikëqyrret dhe dokumentohet zbatimi i kontratës së shërbimit të ruajtjes e sigurisë fizike të ambienteve sipas kërkesës së VKM nr 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VIII, “Ekzekutimi i kontratës”, pika 2 “Mbikëqyrja e kontratës”, nën pika “b”.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se marrja e detyrës nuk dokumentohet me procesverbal marrjen e detyrës, dorëzimin e informacioneve të marra nga institucionet, etj, gjë që bën të shmanget përgjegjësia individuale e secilit punonjës, në kundërshtim me

ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984, VKM nr. 70, datë 11.03.1985 "Për administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin vlerave materiale dhe monetare", ndryshuar, me VKM nr. 170, datë 3.4.1993 "Për disa ndryshime me në VKM nr. 70, datë 11.03.1985 "Për administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin vlerave materiale dhe monetare", dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

14.1 Rekomandimi: Të merren masa që në të ardhmen dorëzimi dhe marrja e detyrës të bëhet e dokumentuar, konform ligjit.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, nuk ishte marrë informacion nga Drejtoritë Rajonale të ALUIZNI-t, mos mbajtje e një database të veçante dhe regjistër për objektet informale të cilat nuk plotësojnë kushtet për legalizim, si dhe mosbashkëpunim e mos marrje informacioni nga pushteti qendror e ai vendor, veprime e mosveprime bien në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin e zonave informale", i ndryshuar, Kreu II, neni 4, pika 1, neni 33, 38, 38/1 dhe 39, si dhe VKM nr. 438 pika "8.1.

15.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren të dhënat nga të gjitha Drejtoritë Rajonale të ndiqen dhe të përpunohen këto të dhëna në për të gjithë objektet që janë ndërtuar në kundërshtim me ligjin me data base përkatës.

Deri më datë 31.03.2015

16. Gjetje nga auditivi: Nga auditimi rezultoi se, sipas bilancit kontabël, në fund të vitit 2013 janë debitorë ndaj Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t prej vitit 2009, *2 persona fizikë dhe 1 person juridik*, në funksion të rekomandimeve të KLSH-së, *në shumën 236,344 lekë*, për të cilët nuk janë ngritur padi civile në gjykatë.

16.1 Rekomandojmë: Të citohen të gjitha procedurat administrative e gjyqësore e arkëtimin e detyrimeve të vlerave 236,344 lekë për 3 debitorët në funksion të rekomandimeve të KLSH-së, si më poshtë:

- 60,900 lekë deficite dhe gjoba personale, sipas Raportit të KLSH-së për 2 punonjësit M. C. dhe A.B. të larguara nga puna.
- 50,871 lekë për pagë tepër sipas Raportit të KLSH-së, për znj. F.K. larguar nga puna.
- 124,573 lekë, sipas Raportit të KLSH-së, që përmban detyrimet e pa likuiduara, për Shoqërinë "N..." shpk.

Brenda datës 31.01.2015

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi për periudhën e auditimit 01.07.2012 deri 31.7.2014, sipas librave të protokollit, nga Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t në 181 raste nuk u ishte kthyer përgjigje kërkesave dhe ankesave të bëra nga persona fizikë apo juridikë, duke zbatuar kërkesat e nenit 61, të Ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative" dhe Kreut 8.6, pika 14, të Rregullores së Brendshme të Funksionimit të ALUIZNI-t. Në rastet e tjera, nuk janë ndjekur deri në fund procedurat e verifikimit dhe kthimit përgjigje ndaj kërkesave, duke ua kaluar për ndjekje drejtorive rajonale pa kthyer përgjigje përfundimtare ndaj kërkesave të qytetarëve dhe subjekteve.

17.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, në vijimësi t'i kthehet përgjigje të gjitha kërkesave dhe ankesave të personave fizike dhe juridike duke u ndjekur deri në fund verifikimi i tyre sipas rrjedhës shteruese, pavarësisht në bashkëpunim dhe kërkesë llogarie ndaj drejtorive rajonale të vartësisë.

Në Vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar se, në 2 raste nuk ishin ndjekur procedurat e verifikimit dhe kthimit përgjigje ndaj kërkesave brenda afateve ligjore të qytetarëve përkatësisht: Nga Drejtoritë Rajonale Tirana 2 dhe Durrës, *lidhur me vonesat në përcjelljen e dokumentacionit në ZVRPP-të Tiranë dhe Durrës, veprime këto në kundërshtim me nenit*

61, të Ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe Kreut 8.6, pika 14, të Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të ALUIZNI-t.

18.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të verifikohet zbatimi nga Drejtoritë Rajonale Tirana 2 dhe Durrës, për të dy rastet e evidentuara më sipër dhe të nisin përgjigjet *lidhur me vonesat në përcjelljen e dokumentacionit në ZVRPP-të përkatëse të bëhet dokumentimi i nevojshëm.*

Brenda datës 31.01.2015

19. Gjetje nga auditimi: Me Urdhrin e Brendshëm nr. 388, datë 03.06.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm, është miratuar formulari tip i kërkesës për legalizim të ndërtimit pa leje/shtesës informale në objekt me leje, në të cilën nuk gjendet në asnjë rubrikë të tyre kërkesa apo shënimi lidhur me paraqitjen e deklaratës noteriale, të projektuesit, zbatuesit dhe investitorit, *për garancinë e qëndrueshmërinë konstruktive të objektit*, ose në mungesë të tyre akti i ekspertimit nga një ekspert ose subjekt i licencuar, sipas nenit 37, pikat a dhe b, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

19.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa dhe të ngrihet grup pune me specialistë dhe auditues të brendshëm të hartohet program tematik për pasojat eventuale nga lëshimi i urdhrin për miratimin e formularit tip të kërkesës për legalizim të ndërtimeve pa leje/shtes informale në objekte me leje në vijimësi, në periudhën kohore përkatëse lidhur me paraqitjen nga aplikuesit të deklaratës noteriale të projektuesit, zbatuesit dhe investitorit, për garancinë e qëndrueshmërinë konstruktive të objektit, ose në mungesë të tyre aktit të ekspertimit nga një ekspert ose subjekt i licencuar.

Deri më 31.03.2015 dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t ka punonjës që nuk plotësojnë kriteret për të qenë auditues të brendshëm të cilët nuk janë pajisur me certifikatë si auditues i brendshëm në kundërshtim me Ligjin Nr. 10318, datë 16.9.2010, *për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, kreu VI Audituesi i Brendshëm, Neni 19 Punësimi, Pika 2.*

20.1 Rekomandimi: Të merren masa dhe të rivlerësohen pozicionet e punës të cilët nuk kanë përvojë audituese dhe certifikate të auditivitetit të brendshëm duke i sistemuar në vende të tjera pune. Rekrutimet e reja të bëhen sipas vlerësimeve e akteve ligjore në fuqi.

Deri më datë 31.03.2015

21. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, janë dhënë 17 masa organizative dhe 10 masa zhdëmtimi në vlerë 1,803,537 lekë nga këto (1,578,537+ 225,000 bono privatizimi) për 5 auditime dhe nuk kanë ndjekje për zhdëmtimin e tyre, veprim ky në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007, neni 4,5 dhe 18 si dhe udhëzimit nr. 12, datë 05.06.2012 pika 2,3,3 pika 2,3,5 dhe pika 2,3,8 si dhe pika 4.1 (dokumentet e auditimit) dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të përgatitur nga Njësia Qendrore e Harmonizimit nr. 69, datë 29.09.2010, për Auditimin e Brendshëm.

21.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore e administrative si për masat organizative dhe masa e zhdëmtim, për dëmin e konstatuar prej **1,803,537 lekë.**

Në Vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t nuk është kryer pagesa e punonjësit *Pëllumb Bataj*, sipas VKM nr 929, datë 17.11.2010, ndryshuar me VKM nr 493, datë 06.07.2011 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” mbështetur në piken 7 si ndihma të menjëhershmetë cilat përballohen nga fondi i veçantë, përfshi pagesat për rastet: e daljes së punonjësve në pension pleqërie, me një pagë mujore.

21.1 Rekomandim: Të merren masa dhe të kryhet pagesa ndihmë e menjëhershme ndajë punonjësit *Pëllumb Bataj*, i cili ka dalë në pension pleqërie, duke zbatuar dispozitat ligjore të cituara më sipër

Brenda datës 31.01.2015

B. MASA PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT

1. Gjetje nga auditimi: Titullari i AK të marrë masa administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në **shumën 137, 984 lekë dëm ekonomik, për tejkalimin e sasisë së kontratës** nr. prot 2610, datë 23.05.2013 “Për blerje karburanti”, për 770 litra x 179.2 lekë/litri, shumë kjo mbi kërkesën, urdhrin e prokurimit dhe kontratën, e ndryshuar dëm ky i shkaktuar nga komisioni i pranimit të mallit i përbërë nga: L.L., E.A.dhe K.C., si dhe B.H., në cilësinë e personit i cili ka firmosur faturën tatimore.

1.1. Rekomandim: Të merren masa administrative e ligjore për kërkesën e shpërblimin e dëmit në vlerën **137, 984 lekë, nga punonjësit** L.L, E.A. dhe K.C. si dhe B.H. (detyrimi në vlerën 34,496 lekë për person).

Brenda datës 31.03.2015

2. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa të padrejta, dieta dhe hotel në linjën Tiranë-Shkodër, megjithëse largësia Tiranë-Shkodër është më e vogël se 100 Km dhe raste pagesash të shpenzimeve të transportit në bazë të biletave të parregullta, të pa miratuara nga Ministria e Financës (DPT), **për 9 punonjës** me efekt të përgjithshëm ekonomik **273,200 lekë**, në kundërshtim me VKM Nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, paragrafi III, pika 1 dhe paragrafi IV, VKM nr. 66, datë 07.02.2007 “Për disa ndryshime në VKM nr. 146, datë 26.02.1998 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar dhe hartës bashkëlidhur dhe me Urdhrin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr. 125, datë 26.12.2011 “Për Miratimin e Hartave të Azhornuara të Rrjetit Rrugor Kombëtar dhe të Distancave Kilometrike Ndërmjet Qyteteve të Shqipërisë”, ku distanca Tiranë-Shkodër rezulton 92 km.

2.1 Rekomandim: Nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit nga 9 punonjës në shumën 273,200 lekë, sipas listës përkatëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit pagesa të pa drejta në udhëtime e dieta brenda vendit.

Deri më datë 31.03.2015

3. Gjetje nga auditimi: Janë kryer shpenzime të paligjshme për telefoninë celulare për llogari të ish-Drejtorit të Përgjithshëm z. A.K. dhe Drejtorit të Përgjithshëm aktual z. A.L., **në shumën 330,742 lekë**, (përkatësisht 229,000 lekë janë përfituar nga z. A.K. dhe 101,742 lekë nga z. A.L.), pagesa këto në kundërshtim me pikën 8, të VKM nr. 864, datë 23.07.2010, e cila i referohet funksioneve sipas lidhjes 6, ku limiti i shpenzimeve mujore për celularin e Drejtorit të Përgjithshëm është 10,000 lekë, kur janë kryer pagesa për këtë qëllim deri në 35,000 lekë në muaj, sipas lidhjes 5, pjesë në të cilën trajtohen vetëm drejtorët e përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Doganave dhe Tatimeve.

3.1 Rekomandim: Nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative me qëllim kërkimin për **shpërblimin e dëmit në vlerën 330,742 lekë**, prej të cilave për ish-Drejtorin e Përgjithshëm z. A.K. për 229,000 lekë dhe Drejtorin e Përgjithshëm aktual z. A. L. Për 101,742 lekë.

Deri më datë 31.03.2015

4. Gjetje nga auditivi: Nga komisionet e ngritura për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, për vitet 2013 dhe 2014, janë kryer vlerësime për nxjerrje jashtë përdorimit të këtyre aktiveve, të cilat duhej t'u viheshin në ngarkim personave, të cilët i kishin në inventar, si dhe janë trajtuar hollësisht e nuk ishin argumentuar arsyet për ç'vlerësimin e secilit prej artikujve, se përse duhej të nxirreshin jashtë përdorimit dhe mospërdorim në ALUIZNI-n Qendror ose në njësitë e vartësisë, janë konstatuar, **në 20 raste për shumën 648,858 lekë**, në mos përmbushje të pikave 103, 104, 106, 110, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Vlerësimi i tyre për nxjerrjen jashtë përdorimit ishte bërë me arsyetime të tilla antiligjore si "personave që i kanë patur i kanë rënë nga duart dhe janë dëmtuar"; "u dëmtua gjatë çmontimit pasi salla ku ishte vendosur u bë Arkiv"; "u dëmtuan nga anëtarët e komisionit të votimeve në zgjedhjet që u bënë më datë 23.06.2013"; ose thjesht "janë prishur" pa asnjë analizë për shkaqet. *Theksojmë së, sipas tabelave të ç'vlerësimit, aktivet kanë patur një amortizim linear prej rreth 20 %.*

4.1 Rekomandim: Nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të vlerësohen veprimet e kryera nga punonjësit dhe në rastet e nxjerrjes së përgjegjësisë për këto raste të merren masa administrative për zhdëmtim.

Deri më datë 30.06.2015

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37 dhe 144, të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenit 12 të kontratës individuale të punës, t'i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, që të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

C/1. "Vërejtje", qerma "a".

1. znj. L.L. Anëtar i komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi

2. z. E.C. Anëtar i komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi

3. z. Z.T. Anëtar i komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit

4. z. D.S. Kryetar i komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi

5. z. R.G. Anëtar i komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi

6. z. S.B. Anëtar i komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi

7. z. B.B. Anëtar i komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi

Për hartimin e procesverbaleve për nxjerrjen jashtë përdorimit pa përshkruar në mënyrë të hollësishme për secilin artikull, se ç'procedurë është ndjekur për nxjerrjen jashtë përdorimit, në kundërshtim me pikën 110, të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011.

8. z. E.Z. me detyrë Përgjegjës aktual i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Për mos ndjekje sipas rregullores e dispozitave ligjore të 17 masa organizative dhe 10 masa zhdëmtimi në vlerë 1,803,537 lekë nga këto (1,578,537+225,000 bono privatizimi) nuk kanë ndjekje për zhdëmtimin e tyre veprim ky në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007, neni 4,5 dhe 18 si dhe udhëzimit nr. 12, datë 05.06.2012 pika 2,3,3 pika 2,3,5 dhe pika 2,3,8 si dhe pika 4.1 (dokumentet e auditimit) dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të përgatitur nga Njësia Qendrore e Harmonizimit nr. 69, datë 29.09.2010, për Auditimin e Brendshëm.

9. z. E.A. Anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave

10. z. K.Ç. Anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave

Për kontratat me objekt "Blerje tonera", nr. 2466, datë 15.05.2013, me vlerë 9,698,936 lekë, "Blerje Kancelari", nr. 2465, datë 15.05.2013, me vlerë 600,533 lekë, "Blerje letër",

nr. 2464, datë 15.05.2013, në shumën 3,500,640 lekë, “Karburant diesel (gazoil)” nr. 4067, datë 28.08.2013, me vlerë 1,320,000 lekë, “Benzinë pa plumb” nr. 4093, datë 02.09.2013, me vlerë 1,800,000 lekë, nr. 675, datë 11.02.2013, me vlerë 1.301.760 lekë, nr. 431, datë 31.01.2013, me vlerë 609.578 lekë, nr. 429, datë 31.01.2013, me vlerë 148,046 lekë, nr. 429, datë 31.01.2013, me vlerë 137,667 lekë, nr. 733 prot datë 13.02.2013, me vlerë 278,880 lekë.

11. z. I.B. Anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave

12. z. M.S. Anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave

13. z. A.S. Anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave

14. z. A.H. Anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave

Si Anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave për;

Për kontratat nr. 5211, datë 05.06.2014, dhe kontratat për blerje karburant për diesel 1,632,000 lekë dhe benzinë pa plumb për 894,000 lekë

Pasi kanë hartuar certifikatat e marrjes në dorëzim të mallrave, në kundërshtim me Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, nënpikat 42, 43, 47 dhe 50, si dhe në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VIII, “Ekzekutimi i kontratës”, pika 2, “Mbikëqyrja e kontratës”.

C/2. “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për:

1. znj J.V. me detyrë Koordinatorë dhe Drejtor i Legalizimit dhe Planifikimit për:

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e dispozitave ligjore, mos marrje informacion nga Drejtoritë Rajonale të ALUIZNI-t, mos mbajtje e një database të veçante dhe regjistër për objektet informale të cilat nuk plotësojnë kushtet për legalizim, si dhe mosbashkëpunim e mos marrje informacioni nga pushteti qendror e ai vendor, veprime e mosveprime bien në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin e zonave informale”, i ndryshuar, Kreu II, neni 4, pika 1, neni 33, 38, 38/1 dhe 39 , si dhe VKM nr. 438 pika “8.1.

-Mungesë bashkëpunimi me Drejtoritë Rajonale të ALUIZNI-t, institucionet e tjera si:Ujësjellës-Kanalizime, Institutin e Monumenteve të Kulturës, për Zonat Arkeologjike, Ministrinë e Mjedisit, INUK, INUV, Bashkitë e Komunitet, këto në zbatim të pikës 2.4, të urdhrat të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 291, datë 01.09.2008, urdhrat nr. 2981, datë 11.06.2014, si dhe të Rregullores nr. 62, datë 16.01.2008, Kapitulli VI, pika 12 (a,b,c), kapitulli VI/3 pika 7 dhe 10(a,b,c), (sektori legalizimit).

- Mos dokumentim me procesverbal, mbi marrjen e detyrës, dorëzimin e saj, informacione të marra nga institucionet etj, gjë e cila sjell si pasojë shmangien e përgjegjësisë individuale të secilit punonjës, mosveprim ky që vjen në kundërshtim me ligjin nr. 6942, datë 25.12.184, VKM nr. 70, datë 11.03.1985 “Për administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin vlerave materiale dhe monetare”, ndryshuar, me VKM nr. 170, datë 3.4.1993 “Për disa ndryshime me në VKM nr. 70, datë 11.03.1985 “Për administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin vlerave materiale dhe monetare”, dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

2. znj. R.A. me detyrë ish-Përgjegjëse e Njesisë së Auditimit të Brendshëm për:

- Dosjet e auditimeve të përfunduara, nuk janë të kompletuara dhe të arshivuara, kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007, ligjin nr. 6942, datë 25.12.184, VKM nr.

70, datë 11.03.1985 "Për administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin vlerave materiale dhe monetare", ndryshuar, me VKM nr. 170, datë 3.4.1993 "Për disa ndryshime me në VKM nr. 70, datë 11.03.1985 "Për administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin vlerave materiale dhe monetare", dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"

-Programet e punës kanë qenë të njëjtit format, nuk ka pasur grup auditimi, por janë kontrolluar vetëm nga Përgjegjësja e Auditimit, nuk ka ndarje detyrash, akt verifikime ose proces verbale të mbajtur në Drejtoritë Rajonale të ALUIZNI-t, nuk ka as një rekomandim për ndreqjen e parregullsive (kryesisht viti 2012), në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, neni 4,5 dhe 18 si dhe udhëzimit nr. 12, datë 05.06.2012 pika 2,3,3 pika 2,3,5 dhe pika 2,3,8 si dhe pika 4.1 (dokumentet e auditimit) dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të përgatitur nga Njësia Qendrore e Harmonizimit nr.69, datë 29.09.2010, për Auditimin e Brendshëm si dhe rregullores nr. 62. prot. datë 16.01.2008 kapitulli V pika 1 dhe pika 3,

-Nuk janë arkivuar dosjet e auditimeve të kryera sipas normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë" e Drejtorisë të Arkivave sipas të ligjit 9154 date 06.11.2003 për arkivat (Neni 23,pika 1. Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore janë pjese organike e tyre dhe varen drejtpërdrejt nga drejtuesi i institucionit.), si dhe udhëzimeve përkatëse dhe rregullores nr 62. prot. datë 16.01.2008, pika 8.4 (Sektori i Arshivës dhe Protokollit).

3. z. K.Ç. anëtar i komisionit të vlerësimit

4. z. B.H. anëtar i komisionit të vlerësimit

5. znj. A.H. anëtar i komisionit të vlerësimit

6. z. F.M. anëtar i komisionit të vlerësimit

-Për kryerje vlerësime për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve të institucionit, për vitin 2014, me arsyetime të tilla antiligjore si thjesht "janë prishur" pa asnjë analizë për shkaqet, duke mos trajtuar hollësisht e mos argumentuar arsyet për ç`vlerësimin e secilit prej artikujve, se përse duhej të nxirreshin jashtë përdorimit dhe përse nuk mund të përdroreshin në ALUIZNI-n Qendror ose në njësitë e vartësisë dhe pse të mos u jepeshin njësive të tjera, konstatuar, **në 14 raste për shumën 218,286 lekë**, në mos përmbushje të pikave 103, 104, 106, 110, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*Theksojmë së, sipas tabelave të ç`vlerësimit, aktivet kanë patur një amortizim linear prej rreth 20 %.*

7. zj L.L. anëtare e Njesisë së hartimit të dokumenteve të tenderit

Për vitin 2012, në tenderin me procedurë "Kërkesë për propozim", me objekt: "Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të ambienteve në administrim të Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t ", në kërkesat për kualifikim, ka miratuar si kriter: "Autorizim individual për radio komunikim dhe radio alarm të lëshuar nga AKEP për zonën e Tiranës dhe vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve ndaj AKEP, (mandat pagesën bankare). Kryerja e këtij shërbimi duhet të jetë përcaktuar edhe në ekstraktin e QKR", kërkesë kjo e ekzagjeruar në kundërshtim me qëllimin e parimet e LPP, nenet 1, 2 dhe 20. Kjo është kërkesë diskriminuese dhe shkel barazinë në tendera, vendosja e pasaktë, dhe jo e qartë e numrit të rojeve, për numrin e rojeve në DT, nuk është përcaktuar qartë koha ditore e shërbimit, nuk është përcaktuar nëse shërbimi është 24 orë pa ndërprerje për të gjitha ditët, nuk ka grafik shpërndarje si dhe koeficient ditor të rojeve përditë roje. Nuk janë analizuar shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu VII, "Kushte të përgjithshme për zbatim", pika 1, "Mungesa e konkurrencës", pika "b",

Për vitin 2013 në tenderët e zhvilluar me “Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, “Shërbimi i mirëmbajtjes së aparaturave e pajisjeve teknike – shtesë kontrate”, “Blerje tonera – shtesë kontrate”, “Blerje kancelari – shtesë kontrate”, “Blerje letër – shtesë kontrate”, “Blerje karburanti – benzinë”, nuk është përcaktuar asnjë dokumentacion që do të paraqitet nga operatori ekonomik. Në tenderin me “Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, me objekt “Blerje karburanti”, me fond limit 1.000.000 lekë dhe “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të ambienteve në administrim të Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t” përzgjedhja e procedurës së prokurimit është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 1, “Qëllimi i ligjit” dhe 33, “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu IV, “Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”, pika 5, “Procedura me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, pika a, dhe Udhëzimin e mësipërm të APP së, pika 9

Për vitin 2013, për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike të ambienteve në administrim të Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t, janë zhvilluar 5 procedura prokurimi, 3 me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, dhe 2 kërkesë për propozim, për të cilat në llogaritjen e preventivit të fondit limit në asnjë rast nuk u paraqit dokument që të vërtetojë se sa është shuma sipas zërave të planifikuar për këtë shërbim (kostot për shërbimet që do të kryhen nga ofertuesi si: kohëzgjatja e pushimeve vjetore, për pa aftësi në punë, për pushimet javore, etj, bazuar në “Kodin e Punës”, nenet 92, 81, dhe 87, llogaritja e sigurimeve shoqërore referuar VKM nr. 1114, datë 30.07.2008, “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.2003”, pika III/ 3, llogaritje në zbatim të Urdhrit nr. 3644, datë 07.12.2011, “Për aplikimin e tarifave në kryerjen e shërbimit ndaj të tretëve”, Urdhrit nr. 1490, datë 21.06.2001, të Ministrisë së Rendit Publik, “Për përcaktimin e uniformës së punonjësit të shërbimit të shoqërisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, shpenzimet për armatim, paga bazë sipas VKM nr. 285, datë 04.05.2007, për efekt të pagës referuese të sigurimeve shoqërore, lidhja 74.6, si dhe VKM nr.445, datë 11.07.2012. Në llogaritjen e këtij shërbimi në të gjitha procedurat kërkesat për shërbimin janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23, pika 1 dhe 4 në VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu III, pika 3/c,

Nga mos marrja e masave për zhvillimin e procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim”, që në momentin e lidhjes së kontratës shtesë në masën 20% si dhe nga vlerësimi i gabuar i KVO, rezulton efekt negativ ekonomik për AK prej 140,765 lekë.

Për tenderin me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të ambienteve në administrim të Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t” me “Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit” urdhri i prokurimit nr.16/ 21.01.2013, ka dalë 21 ditë pas lindjes së nevojës për këtë shërbim, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika “ç”, duke sjellë për pasojë lidhjen e kontratës nr. 3015, datë 21.01.2012, me operatorin fitues “N...” shpk me fuqi prapavepruese duke shkaktuar një efekt ekonomik negativ prej 174,782 lekë.

Nga Drejtoria Qendrore e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, me shkresë nr. 6366/5, prot, datë 16.01.2014, protokolluar në KLSH me nr.768/16 datë 21.01.2015, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Hysen Metko, Aleksandër Papadhimetri dhe Lolita Baholli, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT